


Covid-19 Testim nga Makina

350 Plantation Street, Worcester, MA 01605



Regjistrohuni për myChart (kartela ime), faqja e rrjetit tonë për pacientët, e sigurt dhe e lehtë për t'u përdorur që ju hap juve rrugë në informacionin tuaj shëndetësor.

Vizitoni: www.umassmemorial.org/mychart

UDHËZIMET PËR TESTIM NË MBRRITJE
CFARË TË PRITET

Si mund të përgatitem për testin tim?

Mos hani dhe as mos pini, mos lani dhëmbët, mos përdorni solucion për larje goje, mos përtypni çamçakiz ose vendosni buzëkuq për 30 minuta para se të merret kampioni juaj. Ju do të refuzoheni dhe do t'ju kërkohet të ktheheni prap në rast se keni ngrënë ose keni pasur diçka për të pirë.

Çfarë ndodh kur të arrij?

- Ju do të përshëndeteni nga stafi i shërbimit të makinave. Qëndroni në makinën tuaj në çdo kohë
- Ju lutemi kushtojini vëmendje me kujdes udhëzimeve të tyre dhe ngisni makinën ngadalë.
- Përvoja juaj do të jetë e ngjashme me veprimin bankar nga makina.

Cili është procesi i mbledhjes së kampionit?

- Përdoret testi i pështymës
- Një nga personeli i shërbimit të makinave do t'ju dorëzojë një paketë me paisjet e parapërgatitura për mbledhjen e pështymës. Ju lutemi prodhoni pështymë të mjaftueshme duke pështyrë ose lëshuar lirshëm jargë në tub duke e mbushur atë deri sa të arrijë në shenjën # 5 në tub.
- Mendoni për diçka të thartë që të ndihmojë në sekretimin e lëngjeve në gojën tuaj.
- Nuk nevojitet kollitje produktive - vetëm pështymë e lëngshme.

Po sikur të mos mund të prodhoj pështymë?

- Kur të arrini në dritaren e shërbimit, do t'ju jepet një paketë me paisjet/tampon me vetë-përdorim.
- Personeli do t'ju ofrojë udhëzime dhe mbikëqyrje. Ju do të fërkoni një tampon me majë pambuku në pjesën e brendshme të secilës hapje të hundës tuaj
- Për Fëmijët e vegjël që kanë nevojë për infermieren tonë për të mbledhur kampionin do t'ju ofrohet udhëzim në dritaren e shërbimit kur të bëni regjistrimin.

Çfarë ndodh në dritaren e shërbimit?

- Kini patentën e shoferit dhe kartën tuaj të sigurimit shëndetsor gati për t'ia dhënë stafit të regjistrimit.
- Sapo të arrini te dritarja, vendoseni makinën tuaj në park. Do t'ju kërkohet t'i lini këto artikuj në kutinë e vendosur te dritarja për dorëzimin e tyre.
- Mbylleni radion tuaj, në mënyrë që të dëgjoni dhe flisni me personelin e spitalit duke përdorur intercomin në kuti.
- Do t'ju kërkohet numri juaj i telefonit në mënyrë që të kemi informacionin e saktë të kontaktit tuaj të në sistemin kompjuterik. Ky është numri që zyra e mjekut tuaj do të telefonojë me rezultatet.
- Personeli do të marrë kampionin tuaj dhe do ta etiketojë për testim.

Kur do i marrë rezultatet e mia?

Rezultatet do të jenë gati brenda 24 orësh. Zyra e mjekut tuaj do t'ju telefonojë.